

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

TRYEZË E NIVELIT TË LARTË PËR PROCESIN E INTEGRIMIT



Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore" dhe kriteri politik, hapin dhe mbyllin procesin e anëtarësimit si pjesa më e rëndësishme, ndaj dhe performanca e negociatorëve tanë duhet të jetë 120 përqind, ndërsa funksionimi i gjithë ingranazhit duhet t'i ngjajë një sahati. Diskutuar në këtë tryezë të parë, mbi sfidat që na presin dhe për të cilat çdokush duhet të jetë gati. Nuk është një punë, nuk është një projekt! Anëtarësimi në BE është ëndërra e miliona shqiptarëve, dhe të gjithë duhet të ndihemi krenarë që jemi përzgjedhur të jemi pjesë e punës për realizimin e kësaj ëndrre!

LEXO PËR MË SHUMË

INSPEKTIM I ZYRAVE TË NDIHMËS JURIDIKE VLORË DHE SHKODËR

Me ndihmën e paçmuar të PNUD, qeverisë austriake, partneritetit me ADA si dhe projektit EFLAS, ndihma për qytetarët në nevojë kudo në Shqipëri, do të njohë vetëm rritje. Është mbresëlënëse ku vetëm për një vit, Zyra e Ndhmës Juridike në Vlorë ka trajtuar mbi 260 raste dhe Zyra e Ndhmës Juridike në Shkodër ka trajtuar 410 raste.

LEXO PËR MË SHUMË

MINISTRI I DREJTËSISË LANÇON NGA IEVP REÇ FAZËN E DYTË TË PUNËSIMEVE

Në IEVP Reç, synojmë punësimin e rreth 200 të dënuarve në bashkëpunim me biznesin fason. Ka nisur trajnimi i grupit të parë me 70 persona në konflikt me ligjin. Brenda këtij viti synojmë punësimin e 800 të dënuarve në të gjitha IEVP e vendit.

LEXO PËR MË SHUMË



INSPEKTIM I ZYRAVE TË SHËRBIMIT TË PROVËS TIRANË, SHKODËR DHE KORÇË

Drejtorja e Shërbimit të Provës, trajton raste të dënimeve alternative dhe është ndër njësitë me metodologjinë më të mirë në përgatitjen e dosjeve për personat nën mbikëqyrje.

Besoj puna e tyre do të përmirësohet edhe më tej, pas digjitalizimit të arkivës 13 vjeçare, por edhe angazhimit tim personal për një akomodim më serioz dhe të përshtatshëm të kësaj drejtorie.

LEXO PËR MË SHUMË



PJESËMARRJE NË FORUMIN E POLITIKAVE RAJONALE PËR ANTIKORRUPSIONIN

Çelësi i suksesit të luftës kundër korrupsionit, si plagë e përbashkët është koordinimi dhe bashkëpunimi rajonal, përmirësimi i kuadrit ligjor sidomos në fushën e prokurimeve publike, por jo vetëm. Këto duhen shoqëruar ngushtësisht me forcimin e kapaciteteve në burimet njerëzore, dhënie të një roli aktiv qytetarëve, dëgjimi dhe leximi i kujdesshëm i shoqërisë civile dhe mediave. Natyrshëm, gjithçka mbështjellë nga një vullnet i fortë politik, si në rastin e vendit tonë. Shqipëria bazuar në këto hapa, ka rezultate thelbësore në luftën kundër korrupsionit dhe është në rrugën e duhur dhe e gatshme për t'u ulur në tryezën e negociatave.

LEXO PËR MË SHUMË



MINISTRI I DREJTËSISË SHTRON IFTARIN PËR PUNONJËSIT E MINISTRISË SË DREJTËSISË DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI

Si një familje e madhe në Iftarin shtruar për punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të varësisë. Mirësinë, kujdesin e përvulësinë e mbrëmjes së djeshme uroj ta kemi dhe ta gjejmë kudo përgjatë gjithë vitit!

LEXO PËR MË SHUMË



TAKIM PËR DISKUTIMIN E SFIDAVE TË PËRBASHKËTA INTEGRUESE ME KRYETARIN E KUVENDIT TË MAQEDONISË SË VERIUT

Sfidat tona të përbashkëta në rrugën drejt Bashkimit European shpresojmë të kenë një dritë jeshile në Samitin e Qershorit për BP. Përndamë kënaqësinë e statusit të Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit, që i bën nder gjithë rajonit. Ashtu si i bën nder angazhimi ynë i plotë rajonal, me përjashtim të Serbisë, në vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë pas agresionit të saj vdekjeprurës në Ukrainë. Nuk lamë pa diskutuar e shkëmbyer pikëpamjet dhe mundësitë e bashkëpunimit edhe për fusha të tjera mes dy vendeve tona.

LEXO PËR MË SHUMË



Ulsi Manja

5 d ·

Edi kryeministër në Tiranë 🇹🇷 Albini në Kosovë 🇲🇰 dhe nga sot Dritani në Mal të Zi 🇲🇪
Erëra të mira në Ballkan dhe ne shqiptarët si kurrë më parë, kemi shansin të tregojmë se ndërtojmë ura për një rajon të qetë që sheh drejt Bashkimit European! 🇪🇺

MINISTRI I DREJTËSISË URON PËR ZGJEDHJEN KRYEMINISTRIN E RI TË MALIT TË ZI

Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja ka uruar zgjedhjen e z. Dritan Abazoviç si kryeministër i Malit të Zi. Pro tij votuan 45 deputetë. Është hera e parë që një shqiptar zgjidhet në drejtim të qeverisë malazeze.

"Edi kryeministër në Tiranë, Albini në Kosovë dhe nga sot Dritani në Mal të Zi. Erëra të mira në Ballkan dhe ne shqiptarët si kurrë më parë, kemi shansin të tregojmë se ndërtojmë ura për një rajon të qetë që sheh drejt Bashkimit European!", ka shkruar Ministri i Drejtësisë në rrjetet e tij sociale.

LEXO PËR MË SHUMË

